


Macja më e rrallë

Ndryshe nga një mace e zakonshme, rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*) ka përmasa trupore më të mëdha, që arrin një gjatësi deri në 130 cm. Gëzofi i tij është i mbuluar me pulla të zeza, të cilat janë unike dhe ndihmojnë ekspertët për t'i dalluar individët nga njëri-tjetri. Rrëqebulli i Ballkanit është një nënloj i rrëqebullit Euroaziatik (*Lynx lynx*) që gjendet vetëm në gadishullin e Ballkanit, në shtete si Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Rrëqebulli është një kafshë mishngrënëse që ushqehet kryesisht me thundrakë si kaprolli apo dhia e egër. Megjithatë, kjo mace gjuan edhe lepuj të egër, si dhe kafshë të tjera me përmasa të vogla.



Shqipëri: jo më shumë se 10 individë

Përhapja e rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut më pak se 50 individë



1 - 5 këlyshë, zakonisht 2 ose 3 këlyshë

Rrëqebulli jeton më së shumti i veçuar dhe takohet me rrëqebuj të tjerë vetëm gjatë periudhës së riprodhimit, që ndodh ndërmjet muajve Shkurt-Prill. Gjatë pjesës tjetër të vitit, rrëqebulli tregon sjellje territoriale, duke zënë territore nga 100-300 km². Kufinj të territoreve ky lloj i shënjon nëpërmjet urinës dhe sekrecioneve.

Një mace e rrezikuar

Praktika si prerja e paligjshme e pyjeve, apo gjuetia e paligjshme kanë bërë që rrëqebulli të humbasë habitatin natyror të përshtatshëm për të jetuar, duke e detyruar këtë lloj të strehohet vetëm në disa zona të Shqipërisë, si p.sh. në Parkun Natyror të Munellës. Përmes kamerave kurth, PPNEA ka fotografuar individë në zona të ndryshme të vendit me qëllim vlerësimin e madhësisë së popullatës së rrëqebullit. Ai është fotografuar edhe në zonën

xhufka në majat e veshëve



bishti i shkurtër me majë të zeze

gëzofi i mbuluar me pulla të zeza

këmbë të gjata

12 - 35 KG

tipare identifikuese të Rrëqebullit të Ballkanit

Polis-Valamarë, Alpet e Shqipërisë, Parkun Kombëtar të Shebenikut, si dhe në Parkun Kombëtar të Prespës.

Rrëqebulli i Ballkanit është klasifikuar si i rrezikuar në mënyrë kritike për zhdukje në nivel global. Kërcënohet nga gjuetia e paligjshme!

Në vitin 2020, tre individë të këtij lloji janë gjendur të balsamosur e të ekspozuar në një restorant në afërsi të qytetit të Elbasanit.

Disa kuriozitete rreth rrëqebullit



- ✿ A e dinit se rrëqebulli është macja më e rrallë në botë?
- ✿ Shikimi i rrëqebullit është 6 herë më i fortë se sa ai i njeriut.
- ✿ Rrëqebulli qëndron në majë të zinxhirit ushqimor. Për këtë arsye, ky lloj nuk rrezikohet nga grabitqarë të tjerë. Rreziqet kryesore ndaj rrëqebullit të Ballkanit lidhen kryesisht me aktivitetin e njeriut.
- ✿ Gjuetia e rrëqebullit është një akt i dënueshëm deri në 7 vite heqje lirie.
- ✿ Fotografia e parë e rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri është realizuar në vitin 2011 gjatë një monitorimi ekstensiv me kamera kurth në Malin e Munellës.



Rrëqebulli mbrohet nga legjislacioni shqiptar dhe konventa ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës.



- Konventa Ndërkombëtare për Tregtinë e Llojeve në Rrezik (CITES)
- Konventa e Bernës
- Direktiva e Habitaveve e BE-së



Ligji Nr. 10 006, datë 23.10.2008,
“Për mbrojtjen e faunës së egër”.



Ligji Nr.10 253, datë 11.3.2010,
“Për Gjuetinë”

PPNEA është organizata nismëtare për studimin dhe ruajtjen e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri.

Bëhu pjesë e përpjekjeve tona për ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit në Shqipëri.



In partnership with



Supported by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ajencia Zvicëranë për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Funded by
the European Union



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Tirana



AMBASSADE
DE FRANCE
EN ALBANIE
Liberté
Égalité
Fraternité



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



vodafone

RRËQEBULLI I BALLKANIT

Mistik, i fshehtë
dhe i rrezikuar



Albania is Biodiversity